Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Broj. 118/17
Datum. 11.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Qendra Klinike Universitare e Kosovës**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit Visar Emini – Ekspert Teknik		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **118/17** e OE **"Union"** - Prishtinë.		
Datë:	11.05.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 21.04.2017 me Nr. **118/17** nga OE **"Union"** - Prishtinë, për shqyrtimin e lëndës: **"Furnizim me ushqim pluhur për foshnje "**, me numër të prokurimit: QKUK701/17/030/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK).**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **UNION.**

		02.05.2017		**02.05.2017**		**11.05.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 21.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **118/17** e parashtruar nga OE **"Union"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me ushqim pluhur për foshnje "**, me numër të prokurimit: **QKUK701/17/030/121**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK).**
Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK).**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues "Union", me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE "" - dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 28 – Specifikimet teknike.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:
Tek pjesa e II. Përshkrimi i çmimeve tek dosja e tenderit janë te cekura si me poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Paketimi	Specifikat	Koment	Propozim
1.	Ushqim pluhur për foshnje (0-6 muaj)	300 gr.	Niveli i proteinave 1.8g pluhur. Prania e probiotikeve (Bifidobacterium lactis). Prania e acideve te larta yndyrore (omega 3&6) nukleotideve 100% Laktoz.	Shkelja e pare është bere tek përcaktimi i peshës se paketimit, ku janë te diskriminuar (eliminuar) te gjitha produktet tjera te cilat kane peshe tjetër te produktit. Pastaj tek specifikat e produktit janë përcaktuar saktë te gjithë përbërësit se bashku me peshën/ përqindjen e tyre. Me këto parametra është i favorizuar vetëm një lloj i ushqimit i cili është NAN. Ku e bene eliminimin e menjëhershëm te OE-ve dhe bene shkeljen e parimeve te përgjithshme përkatësisht nenit 6, 8 dhe 28.	Kërkojmë qe te behet ritenderimi me qellim qe te përpilohen specifikimet teknike ne përputhje me nenin 28 te LPP-se.
2.	Ushqim pluhur për foshnje (6-12 muaj)	300 gr.	Niveli i proteinave 1.9g. Prania e acideve te larta yndyrore (Omega 3&6) prania e nukleotideve 100% Laktoz		
3.	Ushqim pluhur për foshnje pa Laktoz	400 gr.	Pa Laktoz prania e probiotikeve. Prania e L.Reuteri		
4.	Ushqim pluhur për foshnje Premature	400 gr.	Prania e MCT 100% Lktoz.		

Nuk kemi pranuar asnjë vendim mbi kërkesën për rishqyrtim te bere sipas nenit 108. Njëjtë është vepruar edhe ne tenderin e kaluar, ku ne kemi qene me ofertë me te lire ndërsa kemi qene te diskriminuar për arsye te licencës si qarkullues me shumice te produkteve farmaceutike. Ku ne rastin tone qumështi për fëmijë nuk e kërkon një gjë te tille pasi qe është me përmbajtje bimore.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 27.03.2017

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Furnizim/vlerë e mesme

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 21.04.2017

Data e hapjes së ofertave .....21.04.2017-13:00^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë kornize – 36 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1: Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit QKUK ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të QKUK, për synimin e dhënies së kontratës.

Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe QKUK do të vazhdojë me tenderuesin eradhës në rang-listë.

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d,e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (origjinali ose kopja e noterizuar).

Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)],vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës].

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.

Kërkesa 2. Certifikatë e numrit fiskal .

Kërkesa 3. Certifikatë e TVSh-së.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Evidenca 1. Te dëshmohet me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-Kopje.

Evidenca 2.Te dëshmohet me Certifikatë te Numrit Fiskal- Kopje.

Evidenca 3.Te dëshmohet me Certifikatë te TVSh-së – Kopje.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
N/A
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Kërkesa 1. Certifikata ISO 9001

Kërkesa 2. Certifikata HACCP

Kërkesa 3. Prezantimi i produktit duhet te behet me katalog te prodhesit, duke i nënvizuar ne Evidenca Ofertuesi duhet ti prezantoj produktet me katalog, duke i nënvizuar ne katalog produktet qe ofertohen.

Kërkesa 4. Autorizim nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi i autorizuar nga prodhuesi. Ne rast te autorizimit nga perfaqesuesi-dileri kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Evidenca 1. Te dëshmohet me kopjen e Certifikatës ISO 9001.

Evidenca 2. Te dëshmohet me kopjen e Certifikatës HACCP.

Evidenca 3. Ofertuesi duhet ti prezantoj produktet me katalog, duke i nënvizuar ne katalog produktet qe ofertohen.

Evidenca 4. Autorizimi nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi i autorizuar nga prodhuesi (me te dhëna mbi prodhuesin: adresa, nr. tel, email, web faqja etj, per mundësi te verifikimit). Ne rast te autorizimit nga perfaqesuesi-dileri kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

OE ankues, konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Pas shqyrtimit dhe analizës së lëndës kemi vërejtur se, AK ka përgatitur specifikat në koordinim me profesionistët përkatës të QKUK-së respektivisht Neonatologët, me ata që kujdesen për shëndetin e femijëve në klinikën e neonatologjisë në QKUK.
Prania e përbërësve të caktuar në "Ushqimin pluhur për foshnje" siç janë: probiotikët, acidet e larta yndyrore etj. dhe prania ose jo e laktozës janë definuar qartë nga AK permes neonatologëve të saj.
Laktoza është sheqeri i qumshtit dhe ka raste kur kërkohet që ushqimi pluhur për fëmijë të jetë pa Laktozë përshak të "Intolerancës nga laktoza" që paraqitet te disa fëmijë e që është paaftësia për tretur sasinë e laktozës, dmth. sheqerin kryesor që gjendet tek qumështi. Kjo situatë ndodh nga mungesa (defiçenca) e sasisë së duhur të një enzime të quajtur 'laktaza' e cila prodhohet nga qelizat e mukozës së zorrës së hollë. Laktaza zbërthen qumështin në dy forma të thjeshta sheqeri: glukozë dhe galaktozë të cilat thithen në gjak.
Fëmijët dhe njerëzit me "Intolerancës nga laktoza" mund të kenë shumë shqetësime. Shenjat të cilat mund të shfaqen nga ato të lehta, deri në më të rënda përfshijnë: Nauze (të përziera); Dhimbje dhe fryrje abdominale (barku); Diarre (barkqitje). Prandaj, neonatologë e definojnë kur nuk duhet të këtë ushqimi laktozë fare. Këtë e ka cekur në specifikim edhe AK në konsultim me neonatologët e vet.
Sa i përket sasisë së "ushqimit pluhur", mund të konfirmoj se shumica e tyre që gjenden në treg është në nivelin e 300 gramëve.
Andaj, eksperti shqyrtues duke u bazuar ne sqarimin e mësipërm, sqaron se është i paqendrushem pretendimi i OE ankues per shkelje te nenit 28 te LPP-se.

Sqarimi nr.2

Eksperti shqyrtues, sqaron pretendimi i OE ankues për shkelje te nenit 108/A te LPP-se, sqaron se AK-QKUK-ja, i ka kthyer vendim me datën: 21.04.2017, ne te njëjtën date ku OE ankues edhe ka parashtruar ankese pran OSHP-se, prandaj, edhe ky pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm. Poashtu është i paqëndrueshëm pretendimi i OE ankues për shkelje te nenit 7 te LPP-se, për faktin se eksperti shqyrtues gjate ekzaminimit te shkresave te lendes nuk ka vërejtur se AK-ja, ka bere diskriminim apo favorizim te OE-ve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)**, për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me ushqim pluhur për foshnje"**, me numër të prokurimit: QKUK701/17/030/121, i ka respektuar dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues-teknik, i propozojnë panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së dhe se ky aktivitet i prokurimit te vazhdoj me tutje, ndërsa ankesën e OE ankues ta refuzoj i te pa bazuar.